



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 5226/Prot.
6

Tiranë, më 01/12/2020

URDHËR

Nr. 407, Datë 01.12.2020

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES
SUADA SHERIFAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të pikës 1, gërmës “ë” të nenit 21 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë” dhe Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

KONSTATOJ:

Në zbatim të urdhrit nr. 214, datë 21.03.2019, “Për përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve ” dhe të urdhrit nr. 396, datë 31.07.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin dhe verifikimin e listës së plotë të dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”, noterja nuk i është përgjigjur urdhrit për dorëzimin e dokumentacionit mbi rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve.

Pas verifikimeve në ekstraktin historik, nxjerrë nga faqja zyrtare e QKB, rezulton se noterja ka pezulluar aktivitetin, në datë 24.09.2019.

U verifikua në sektorin e arkiv protokollit, nëse nga ana e noterës, është vijuar me kërkesë për pezullimin e ushtrimit të profesionit të noterit dhe rezulton se me shkresën nr. S-185 prot., datë 22.10.2019 (28 ditë pas pezullimit të aktivitetit në QKB), noterja i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, ku kërkon pezullim të licencës pasi për kushtet e rënduara shëndetësore e ka të pamundur të jetë prezentë dhe efçente në ushtrimin e profesionit të noterit.

Me shkresën nr. S-185/1., datë 28.10.2019, i është kthyer përgjigje noteres nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, ku në referim të legjislacionit në fuqi, i është sjellë në vëmendje se nga ana e noteres duhet të përcaktohet periudha kohore e pezullimit të licencës, si dhe të paraqitet dokumentacion provues mbi pamundësinë shëndetësore për ushtrimin e profesionit të noterit dhe se vetëm pas administrimit të informacionit të kërkuar dhe dokumentacionit provues do të vijohet me shqyrtimin e kërkesës për pezullim licence nga ana e noteres.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj shkrese i është sjellë në vëmendje se pavarësisht kërkesës, nuk përjashtohet nga detyrimi për të dorëzuar dokumentacionin sipas parashikimeve të Urdhrit nr. 214, datë 21.03.2019, “Për përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”.

Nga verifikimet rezulton se nga ana e noteres nuk është kthyer përgjigje ndaj kësaj shkrese.

Neni 18, pika 1, në Ligjin nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikon se: *“Noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet përkohësisht, për arsytet e mëposhtme:*

a) për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi. ...

Në pikën 2, të këtij neni parashikohet se: *“Kërkesa për pezullimin e përkohshëm të licencës i drejtohet Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës dhe përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit”.*

Gjithashtu, në pikën 3, të këtij neni, parashikohet se: *“Ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës. Në rast se kërkesa për pezullim është për një periudhë deri në një vit, Ministri i Drejtësisë mund të caktojë një noter tjetër për të administruar arkivin e noterit të pezulluar, gjatë gjithë periudhës së pezullimit të licencës së këtij noteri. Në rast se kërkesa për pezullim bëhet për një periudhë më shumë se një vit, kur Ministri i Drejtësisë vlerëson se nevojat për shërbime noteriale në bashkinë përkatëse janë të larta dhe nuk mund të mbulohen në mënyrë të përshtatshme nga noteri administrues, vendi i noterit konsiderohet vakant dhe plotësohet menjëherë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.”*

Gjithashtu, referuar ekstraktit historik të QKB, data e pezullimit, është data 24.09.2019. Pra rezulton se nga ana e noteres, ka më shumë se një vit që ka pezulluar aktivitetin pa miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

Pas administrimit të këtij informacioni, struktura përgjegjëse kreu verifikimin në Regjistrin Noterial Shqiptar (RNSH), të administruar nga Ministria e Drejtësisë, nga ku rezultoi se noterja nga data 09.06.2018 deri më datë 29.09.2020, nuk ka veprime të regjistruara. Referuar të dhënave të këtij regjistri rezulton se nga data e fillimit të veprimtarisë së noterit 04.05.2016, deri më sot nga noterja janë realizuar vetëm 27 veprime noteriale. Këto veprime janë realizuar vetëm për periudhën 19.01.2017- 09.06.2018.

9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)

